

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-18/05-06

Prishtinë, më 16 mars 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Mahir Yagcilar**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendit i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
8. Shqyrtimi i kërkesës së grupit parlamentar të Partisë reformiste ORA, për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të komisionit për çështje gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
10. Propozimi i rendit të ditës për Seancën Plenare më 24 mars 2006:
  - Shqyrtimi i raportit të Grupit Negociator për bisedimet në Vjenë.

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës për fjalë u lajmëruan këta deputetë:

**Gani Koci** (PDK) pati vërejtje që deputetëve po u shpërndarjen materialet e seancave me vonesë.

**Nimon Alimusaj** (LDK), kërkoi që Kuvendi sa më parë ta shqyrtoi Projektligjin për institucionet e kulturës.

**Fetah Berisha** (LDK) kërkoi që imuniteti i deputetëve të Kuvendit të rregullohet me kartela identifikimi (IT) të veçanta.

**Sabit Rrahmani** (PDAK) kërkoi që të respektohet marrëveshja nga Këshilli Konsultativ për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komuniteteve në bisedimet e Vjenës.

**Emrash Xhemajli** (LPK) kërkoi që IPVQ-të e Kosovës të ndikojnë tek PSPP-ja që veprimtari, **Naser Shatri**, i arrestuari në Austri nga Interpoli, me kërkesë të MPB të Serbisë, të mos ekstradohet në Serbi, si dhe debati për takimin e Vjenës të mos shtyhet për seancën e radhës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kuvendi** miratoi rendin e ditës të kësaj seance, në formën e propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

### **2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 10 marsit 2006.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

**Kuvendi** i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati ishte:

Për-----85;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash **miratoi** Ligjin për veprimtarinë botuese dhe librin.

#### 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 76.

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës njëzëri **miratoi** Ligjin për konfliktet administrative.

**Kryetari dha pauzë pesmbdhjetë minuta.**

Pas pauzës, seanca i vazhdoi punimet me shqyrtimin e parë të projektligjeve.

#### 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Zëvendësministri Agron Dida**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendësministri **Dida** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Dida**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Genc Gorani, Mazllun Kumnova, Xhezair Murati, Ferid Agani** dhe **Gani Koci**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Në fund të debatit, zëvendësministri **Dida** iu përgjigj vërejtjeve të diskutuesve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 45;

Kundër-----37..

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi në parim** Projektligjin për efikasitetin e energjisë.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

## 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Zëvendësministri Blerim Baruti**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendësministri **Blerim Baruti** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Blerim Baruti**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Brikenda Kryeziu, Hatixhe Hoxha, Xhevdet Neziraj, Mahir Yakxhillar, Ferid Agani, Sanije Alaj, Ramadan Kelmendi, Ragip Zekolli, Nafije Berisha, Hydajet Hyseni dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 52;

Kundër-----18;

Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin për miratim

## 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Zëvendësministri Behxhet Brajshori**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendësministri **Behxhet Brajshori** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Behxhet Brajshori**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Mazllun Kumnova dhe Nazim Jashari**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 69;  
Kundër-----1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Përgjegjës - raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin për miratim

#### **8. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare**

**Kuvendi**, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Deputeti **Nazim Jashari** emërohet anëtar i Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, në vend të deputetit Veton Surroi.
2. Deputetja **Teuta Sahatqia** emërohet anëtare e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, në vend të deputetit Veton Surroi.
3. Deputeti **Gazmend Muhaxheri** emërohet anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Nazim Jashari.
4. Deputeti **Genc Gorani** emërohet anëtar i Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, në vend të deputetes Teuta Sahatqia.

#### **9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

Rekomandimin e Komisionit lidhur me listën për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, e arsyetoi **Hydajet Hyseni**, kryetar i këtij komisioni.

**Ramadan Kelmendi**, anëtar i Komisionit Legjislativ, tha se në listën e të propozuarve për anëtar të Këshillit Gjyqësor ka kandidat që, në të kaluarën, kanë zbatuar ligje diskriminuese mbi baza nacionale, që është në kundërshtim me kodin e etikës dhe të profesionit të gjyqtarit. Do të ishte mirë që kjo të ndërpritet.

**Kryetari** e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----36;

Kundër-----29;

Abstenime-----11.

**Kryetari** konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

## **V E N D I M**

I. Kuvendi i Kosovës miratoi listën e kandidatëve për anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të propozuar nga radhët e gjyqtarëve, prokurove dhe Universiteti i Prishtinës, në këtë përbërje:

1. Zait Xhemajli – Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Ismet Kabashi – Prokuroria Publike e Kosovës,
3. Jelena Krivokapiq – Gjykatat e Qarkut ,
4. Selim Nikçi – Gjykatat Komunale dhe
5. Prof. dr. Enver Hasani – Universiteti i Prishtinës.

### **10 Miratimi i rendit të ditës për seancën e radhës**

**Kuvendi**, me propozim të Kryesisë miratoi rendin e ditës të seancës plenare më **24 mars** 2006, si vijon:

1. Shqyrtimi i raportit të Grupit Negociator për rrjedhat e bisedimeve në Vjenë.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

---

E hartoi

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**